



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN  
MINISTRI

Nr. 1400 Prot.

Tiranë, më 16/03 / 2017

**UDHËZIM**

Nr. 1, datë 16.03.2017

**PËR**

**MËNYRËN DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 5 dhe 8 të Ligjit nr. 107/2014, datë 30.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 14 të Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, nenit 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 27.6.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”,

**UDHËZOJ:**

**A. Rregulla të përgjithshme**

1. Planet e Përgjithshme Vendore zbatohen nëpërmjet planeve vendore sektoriale, planeve të detajuara vendore, të parashikuara në dokumentin e planit, si dhe lejeve të ndërtimit të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse, sipas nenit 27 të ligjit 107/2014, datë 30.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
2. Pas miratimit të Planeve të Përgjithshme Vendore në Këshillin Kombëtar të Territorit, Bashkitë:
  - a) Fillojnë menjëherë hartimin e planeve të detajuara vendore, me nismë publike sipas prioriteteve të tyre të zhvillimit dhe bashkërendimin e punës me të gjitha palët e përfshira për hartimin e planeve të detajuara vendore me nismë private, kur paraqitet kërkesa, sipas rasteve të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Vendor të Territorit.
  - b) Fillojnë, menjëherë, hartimin e planeve sektoriale të infrastrukturës rrugore dhe të hapësirave publike, në rastet kur Plani i Përgjithshëm Vendor i përcakton këto plane si kusht paraprak për vijimin me leje ndërtimi në zonat për të cilat nuk kërkohet PDV-ja.

